

Heroina është derivat gjysëmsintetik i morfinit. Për herë të parë është prodhuar në Gjermani në vitin 1898 dhe është përdorur në mjekësi në shërimin e kollitjes dhe dhimbjeve. Heroina ka 20-25 herë ndikim më të madh analgetik se sa morfina dhe është dy herë adiktiv më i fuqishëm. Keqpërdorimi i saj sjell deri në zhvillimin e varësisë së rëndë fizike dhe psikike, vetëm për disa ditë. Gjetet në formë të pluhurit të bardhë (më e pastërt, me ndikim më të fuqishëm) apo me ngjyrë gri në të kafe.

Konsumimi: Heroina mund të futet në organizëm me pirje të cigares në të cilët futet heroina, me hiqje nëpërmjet hundës, me thithje të avullit të heroinës së ndezur në foli dhe intravenoz, me injeksion dhe gjilpërë. Kur përdoret në mënyrë intravenoze nevojiten t.e. “pajisje”: lugë, qiri, limontoz, najllon, pambukë, injeksione, gjilpëra, shtrëngues (llastik). Pas futjes në organizëm heroina ka ndikim gjithsej prej 4 –6 or, për kohën e së cilës ndryshohen fazat e ndikimit të saj:

- **Faza 1:** gjendja e “High” t.e. gjendje e mpirjes së lartë. Fillon menjëherë pas futjes së heroinës në organizëm dhe zgjat mesatarisht prej 10 – 15 minuta. Shenjat tipike janë: reaksione të ngadalësuara, shpirtgjërësi ndaj rrethit, pa dhimbje, ngurtësim (“stoun”). Bebëzat janë të zvogëluara, si pikë, si maja e gjilpërës, nuk reagojnë në dritë.
- **Faza 2:** është gjendje e a.q. barazpeshë e rrafshtë psikike, kur njeriu i cili ka konsumuar heroinë funksionon pa rënë në sy për rrethin, posaçërisht nëse konsumon një kohë të gjatë. Kjo fazë zgjat 3-6 orë.
- **Faza 3:** është gjendje pasi të kalojë ndikimi i heroinës, t.e. paraqitja e shenjave të abstenimit (kriza). Fillon pas 8-12 orë nga marja e heroinës, me shenja të: padisponimit, nervozë, tolerancë të ulur të frustracionit dhe eksplozivitetit, rrjedhje të hundës, lotim, djersitje, rrënoqethje, lëvizje të shpejta papritmas të muskujve të dorës / këmbës, gjum të parehatshëm, bebëza të zmadhuara, dhembje në shpinë dhe në eshtra, gërditje, vjellje, barkqitje, temperaturë të ngritur. Kulminacioni i shenjave të theksuara ndodh për 36 – 48 orë, ndërsa ndalja pritet për 7 – 15 ditë.

Shenjat tipike objektive nga keqpërdorimi i heroinës janë: bebëza të zvogëluara, kruarje në lëkurë, kotje, shpesh herë zbehje, shenja nga shpuarjet me gjilpërë nëpër duar, ndezje të venave në duar dhe këmbë, ndryshime të papritura disponimit etj.

Si pasojë e marjes së tepërt të heroinës zhvillohet varësi e rëndë mpirëse, psiko-fizike, në mjekësi e definuar si Sindromi i varësisë nga mpirjet.



LSD është përfaqësues tipik i grupit të drogave të mëdha halucinatore. Ka ndikim të fuqishëm mbi proceset e të menduarit, mbi perceptimet dhe gjendjet e vetëdijes.

Në tregun ilegal paraqitet në formë të hapave mini, LSD letër e butë e impregnuar, folia gjelatini, në të cilat janë të vizatuar Betmeni, Supermeni, Miki Maus etj. Pastaj, pihet edhe i tretur në ujë.

Ndikimi: LSD i futur në organizëm nxit ndryshime trupore dhe psikike. Efektet fillestare janë me paraqitje të ndjenjave të padëshirueshme të pritjes, trishtim pa motivim me dridhje, vjellje, marramendje, kokëdhembje, rrahje e madhe e zemrës, bebëza të zmadhuara. Pastaj, paraqitet huti e tërësishme e ndjenjave, si: halucinacione vizuale në formë të pejsazheve të pasuruara me ngjyra, ndjesi se zërat janë me ngjyrë, ndryshim të sistemeve me vlerë etj. Ndikimi zgjat me orë, e ndonjëherë me ditë.

QASJA TRADICIONALE

Politika tradicionale për zgjidhjen e problemit me drogat bazohet në besimin se:

- Programet preventive të organizuara mirë do të kontribuojnë që rinia aspekt të mos përdorin droga.
- Frikësimi nëpërmjet drejtimeve publike nën sloganan “Droga vret” dhe “Droga është vdekje”, do të kontribuojnë që rinia të mos përdorin apo të ndalen që të përdorin drogë.
- Ata të cilët kanë filluar të përdorin drogë do të ndalen, vetëm nëse dëshirojnë dhe nëse kanë vullnet të fortë që të shërohen.
- Apstenimi është rezultat i vetëm i suksesshëm nga shërimi.
- Mënyra e vetme për zgjidhjen e problemit në bashkësi janë masat të cilat janë të nevojshme në masë sa më të madhe.

Kjo qasje, në bazë të preventivës dhe trajtimit, përfshin aktivitete dhe kahje të veprimit drejtuar jo vetëm kah individi dhe akoma është qasje më e shpeshtë në Republikën e Maqedonisë.

Në programet tradicionale kundërvihet gjendja reale me përdorimin e drogave që thotë:

- Përdorimi i drogave është gjë e pakapërcyeshme në cilën do shoqëri ku ato janë prezente, e për këtë
- Nevojiten programe preventive koordinuese dhe kreative për uljen e kërkesës së drogave. Por edhe përskaaj kësaj
- Drogat janë përdorur, përdoren dhe do të përdoren në cilën do shoqëri, pa dallim të asaj se a e dëshirojmë ne atë apo jo; dhe pa dallim të kualitetit të programeve preventive.
- Për shkak të faktit se vazhdimisht do të ketë persona të cilët do të përdorin dhe keqpërdorin drogë, paraqitet nevoja për programe të ndryshme terapeutike të përshtatura në mundësitë dhe nevojat e grupit qëllimor.
- Përdorimi i drogës është problem i komplikuar dhe socio-medicinale serioz dhe për të zgjidhur atë duhen aktivitete të organizuara dhe të koordinuara në të gjitha segmentet shoqërore.
- Përdorimi i drogës shkakton dëm të madh për individin dhe shoqërinë.

Për shkak të faktit se personat të cilët përdorin drogë janë pjesë integruese e shoqërisë:

- Patjetër të ndërtohet doktrinë e vetme në preventivën dhe trajtimin e përdorimit dhe keqpërdorimit të drogës, si dhe koordinim dhe lidhshmëri e programeve në nivel lokal, nacional, regjional dhe internacional
- Patjetër duhet sigurim shëndetësor dhe social në të gjitha nivelet për personat për personat të cilët keqpërdorin drogën, e para se gjithash sigurim të shërbimeve në nivel të bashkësisë lokale, me çka do të ullet shkalla e margjinalizimit, stigmës dhe izolimi social i tyre.
- Që të shërohen personat e mvarur nga droga të risocializohen, rehabilitohen dhe riintegrohen, patjetër të organizohen programe për riintegrim dhe risocializim në nivel lokal dhe nacional.

WWW.REDCROSS.ORG.MK

www.facebook.com/CrvenKrstNaRepublikaMakedonija

www.youtube.com/MacedonianRedCross

Botimi i kësaj fletushke në mënyrë financiare është përkrahur nga

THE CHURCH OF
JESUS CHRIST
OF LATTER-DAY SAINTS



Црвен крст на Република Македонија
Круќи i куќ i Republikës së Maqedonisë

THE CHURCH OF
JESUS CHRIST
OF LATTER-DAY SAINTS

LËNDËT NARKOTIKE

Çdo vit lëndët narkotike shkatërrojnë jetën e miliona njerëzve. Aspekti më shqetësues i këtij problemi është dëmi që të rinjve ua bën konsumimi i lëndëve narkotike – si dhe kërcënimi që e paraqet për të ardhmen e secilit ved. Për shkak se vazhdimisht rritet numri i të rinjve të cilët fillojnë të përdorin drogat, në aspektin vital është që të sigurohen materiale për edukim të cilat do të përmbajnë informacione të duhura për rrezikun e drogave.

Drogë është secila substancë me prejardhje bimore apo sintetike, me përdorimin e së cilës mund të krijohen gjendje të varshmrëisë, që mund të shkaktojnë dëme në shëndet apo në mënyrë tjetër që ta rrezikojnë integritetin e njeriut në kuptimin fizik, psikik apo social.

Konstatimi i përgjithshëm është se përdorimi i drogave është problem global, serioz dhe i komplikuar. Në botë edhe tek ne droga më e shpërndarë dhe më e përdorur është kanabisi. Por, duke shikuar nga aspekti shëndetësor, social dhe shoqëror është heroini, për hapësirat tona, me siguri droga më serioze ilegale e cila keqpërdoret, para se gjithash për shkak të keqpërdorimit intravenoz që është shumë e rrezikshme për përhapjen e virusit të AIDS, verdhëzës dhe sëmurjeve të tjera bartëse nëpërmjet gjakut, si dhe për rrezikun e vdekjes së shpejtë për shkak të mbidozimit. Rreth 5.3 miliona njerëz në botë të cilët përdorin drogat në mënyrë intravenoze, rreth 200.000 vdesin për shkak të komplikimeve të numërta lidhur me përdorimin e tillë.

Ndarja e drogës është e mundshme në mënyra të ndryshme, por më edukative adekuate mendohet se është ndarja e drogës sipas ndikimit psikofarmalogjik mbi Sistemin nervor qendror (SNQ), sipas së cilës drogat ndahen në: **1. Depresues të SNQ (alkooli, opiumi, sedativat dhe hipnotikët), 2. Stimulues të SNQ (amfetamina, ekstaza, kokaini, krekua, kofeina, efedrina dhe nikotina), 3. Dragoat halucionuese (lsd, meskalin, psilocibin, enilciklidin dhe tatula), 4. Kanabinoidët (marihuana dhe hashashi), 5. Substanca avulluese (ngjitëse, aerosol, tretës, shnëdruesit, benzina, butani, ngjyrat dhe llaku), 6. Steroidë anabolik (dianabol, nandrolon, proviron dhe testosteron).**

Faktet themelore për drohat më shpesh të përdorura:

Marihuana zakonisht mbështjellat si cigare e ashtuqajtur xhoint. Gjithashtu mund të zihet edhe si çaj apo të përzihet me ushqim, apo mund të thithet nëpërmjet llullës të ashtuqajtur bong. Marihuana paraqet drgoë të grupit të drogave të vogla halucionuese, edhe pse sipas disa autorëve kanabisi ndahet në grup të posaçme të drgoës. Fitohet nga gjethet e Cannabis sativa femër (litar indian); prej gjethëve të së cilës, t.e. nga dylli i gjethëve fitohet hashashi.

Ndikimi: Pas prijës (thithjes) së cigares me marihuanë mund të ketë shqetësim fillestar, frikësim dhe emocione. Në tru marihuana ka ndikime depresive dhe ngacmuese. Si shenjë më tipike objektivë gjatë pirjes së marihuanës paraqitet: skuqja e kapakëve të syve dhe konjuktiveve, përcjellur me bebëza të zmadhuara. Goja dhe fyti thahen, por paraqitet edhe oreks i madh për ushqim me kalori të madhe. Mund të ketë çregullim të baraspeshës dhe lodhje. E gjithë kjo përcjellat me manifestime psikike në fushën e gjendjes psikike dhe perceptimeve: gjendja euforike paraqitet pas 15 – 30 minuta, e zgjat 3-4 orë. Personi është në gjendje të relaksuar, me ndjenjë të mirëqenies, komunikon shumë dhe në mënyrë intenzive me rrethinën. Asociacionet janë të gjalla, mendimi i përshpejtuar, por vëmendja e vështirësuar, ndërsa të mbajturit mend i dëmtuar. Në planin trupor paraqitet rritje e shtypjes së gjakut, aksioni i zemrës i përshpejtuar dhe frymëmarrje e përshpejtuar. Pirja intenzive e marihuanës sjell deri në shkatërrimin e më shumë funksioneve psikike: mbajtje mend, kujdes, mendim dhe paraqitje të ndjensës së jo real.



Inhaluesit janë droga të cilat shkaktojnë dëmtime të rënda organike të trurit. Ato bien në grupin e drogave delirante të cilat më shpesh përdoren nga fëmijët e moshës prej 12 deri 16 vjet. Përparësitë e tyre negative janë sepse janë në: shitje legale, të kapshme lehtë, kanë përdorim të gjërë në amvisëri dhe janë lirë. Në shitje gjenden në lloj të: aerosolë, ngjitëse, dezinfektues, insekticidë, dezodoransë, mjete për shkëlqimin e mobiljeve, ngjyra, aceton për thonj, tretës, benzinë, rezerva plini për shkrepse, sprej të ftohtë për plagë etj.

Mënyra më e shpeshtë për përdorim është inhalimi, t.e. me thithje.

Ndikimi: Ndikimi i tyre është depresiv dhe delirant. Në 10 minutat e para paraqiten: ndryshime në sjellje, eufori, ndjenjë e fuqisë, halucinacione, bisedim por me vështirësi në të folurit, bebëza të zmadhuara etj. Përveç kësaj, shpesh paraqiten edhe fotografi të dyfishta, muskulaturë të dobësuar, vetëdije të turbulluar, kotje, dhe fjetje, dezorientim, zbehje rreth buzëve, i pasigurt etj. Një prej karakteristikave më kryesore është paraqitja e agrisivitetit dhe sjelljes violente. Gjatë keqpërdorimit të sërishtëm paraqitet varësi psikologjike.



Amfetaminët janë droga sintetike të prodhuara për herë të parë në vitin 1920 dhe si psikostimulues të fuqishëm menjëherë janë të futura në mjekësi, si mjete kundër lodhjes dhe kotjes. Më vonë, për shkak të efektit depresiv të oreksit janë zbatuar gjatë shërimit të gjendjeve me probleme në të ushqyerit (trashësi). Ekzistojnë të dhëna edhe për zbatimin e tyre masovik nga ana e studentëve, sportistëve, vozitësve në rrugë të gjata për shkak të dukurive të tyre elementare. Prodohen në formë të tabletave, tableta të lyera me sheqer, pika apo lëng për injeksione, pluhur etj. Në organizëm konsumohen nëpërmjet gojës apo gjilpërës, që është shumë rrezik, për shkak të ndikimit të fuqishëm dhe të shpejtë stimulues mbi SNQ.

Ndikimi: të konsumuara në organizëm shkaktojnë ndryshime në planin trupor dhe psikik:

- Plani trupor: shtypje të rritur të gjakut, punë të përshpejtuar të zemrës dhe frymëmarrjes, ngadalësohet puna e zorrëve, dobësim i muskulaturës, lodhje etj).
- Plani psikik: eufori, ndjenjë të rritur të energjisë psikike, ndjenjë për vetbesim, nevojë të ulët për gjum, humbje të oreksit etj.

Gjatë përdorimit të amfetaminin mund të paraqiten halucinacione në të pamurit dhe dëgjimit, shqetësim, nervozë, vetëdije e turbulluar. Gjatë konsumimit të tepërt zhvillohet varësia e tolerancës dhe psikikës.

Ekstaza është drogë sintetike, tabletë, shpesh dhe në mënyrë masive e përdorur si drogë për ahengje, droga “rawy party”, drogë fundjave. Quhet edhe tableta e dashurisë. Në mënyrë masive është përdorur në vitet e 90-ta të shekullit të kaluar, duke e përcjellë kulturën urbane, gjegjësisht tehno ahengjet në vendet evropiane. Përdoret në formë të tabletave e cila përbihet, rrallë hiqet nëpërmjet hundës, e edhe më rrallë në mënyrë intravenoze, me injeksion dhe gjilpërë. Efekti është prej 30 deri 60 minuta nga marja e tabletës, më shumë shprehet pas 90 minutave, e zgjat deri në 3 orë. Pasojat nga kjo drogë akoma testohen **Ndikimi:** Rrezik të posaçëm paraqesin gjendjet e nxemjes së organizmit, për shkak të lëvizjeve ekstreme, aktivitetit motorik, rritja e përnjëhershme e shtypjes së gjakut dhe temperaturës trupore, djersitja e tepërt; si dhe kolapsi i mundshëm i sistemit të zemrës, me çka mund të vjen deri në vdekje.



Kokaina është alkaloid i gjethit të Erytroxylon coca, bimë e cila rritet dhe prodhohet më shpesh në Amerikën Jugore, e prej së cilës përfitohet kokaina (kokainhidro-klorid) në formë të pluhurit të bardhë deri në atë me ngjyrë krem me shije të idhtë. Kokaina njihet si drgoë rekreative dhe konsumohet nëpërmjet gojës (me përbirje), hundës (me hiqje) apo me gjilpërë. Në mjekësi përdoret si anestetik lokal.

Ndikimi: Gjatë marjes së kokainës nëpërmjet hundës ndikimi fillon për 15 – 60 minuta. Paraqitet ndikim i fuqishëm trupor dhe seksual, përcjellur me ndjenjë të fuqisë dhe superioritetit, hiperaktivitetit. E rrit energjinë mentale, nxit eufori që zgjat më së shumti deri në 45 minuta, përmirësim të përkohshëm të të shprehurit. Në plan trupor kjo gjendje përcillet me rritje të shtypjes së gjakut, përshpejtimit të punës së zemrës dhe frymëmarrjes, rritje të temperaturës trupore, bebëza të zmadhuara. Pasi të kalojë ndikimi ndodh gjendje e kundërt: lodhje e fuqishme dhe kotje. Pas përdorimit të tepërt të kokainës vjen shpejtë deri në zhvillimin e tolerancës dhe vatrësi e fu-

qishme psikike.

Keqpërdorimi kronik i kokainës gjithmonë sjell deri në paraqitjen e pagjumësisë, shqetësim, oreks të dobësuar dhe gërditje, dobësim, kanale të dëmtuara të hundës, paranojë etj. shkatërrime shpirtërore serioze.

